



USHTRIA



Viti i 70-të i botimit Nr. 7 (82658)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 19 SHKURT 2016

MINISTRJA KODHELI MORI PJESË NË KONFERENCËN E SIGURISË NË MYNIH



Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, mori pjesë në Konferencën e Sigurisë, e cila u zhvillua nga data 13-14 shkurt 2016 në Mynih të Gjermanisë. Në këtë konferencë morën pjesë disa kryetarë shtetesh, shumë ministra të Jashtëm e të Mbrojtjes, si dhe personalitete të njohur të diplomacisë botërore. Kështu ishte i përnishëm sekretari amerikan i Shtetit, John Kerry, homologu i tij rus, Sergey Lavrov, ministri i Mbrojtjes i Britanisë, Michael Fallon,

ai i Francës Jean-Yves Le Drian, përfaqësues të qeverisë gjermane, si dhe mjaft personalitete të tjerë. Lufta në Siri, katastrofa me emigrantët dhe kriza e sigurisë evropiane ishin çështjet kryesore në axhendën e kësaj konference. Konferenca e 52-të e Sigurisë në Mynih u zhvillua nën udhëheqjen e ambasadorit Eolfgang Ischinger. Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, gjatë punimeve të Konferencës ...

» faqe 2

Prezantohet komandanti i Qendrës së Vëzhgimit Detar

» faqe 2

Qendra e Bashkuar Operacionale Pika nevralgjike e komandimit të Forcave të Armatosura

“Ditë e Hapur” në Qendrën e Bashkuar Operacionale, promovimi i ambienteve të reja dhe i demonstrimit të disa veprimtarive të QBO-së, si pjesë e misionit të saj



» faqe 6-7



KDS

Në AFA certifikohen 29 kursantë që përfunduan Kursin Themelor të Oficerit të Shtabit

Më datën 17.02.2016, në ambientet e Komandës së Doktrinës dhe të Stërvitjes, u zhvillua ceremonia e certifikimit të 29 kursantëve të Kursit Themelor të Oficerit të Shtabit (KTHOSH). Në ceremoni morën pjesë: shefi i Shtabit të KDS...

» faqe 3



Intervista

Shqipëria është në top listën e kontributeve të mëdha, në rolin e saj të paqes, të sigurisë dhe të rregullit botëror

Sa herë zhvillohet ndonjë takim i nivelit të lartë apo një ministerial, si në këtë rast në Mynih, ne gazetarët pyesim: cili është roli i Shqipërisë? A ka ndonjë specifikë këtë herë që ne të themi për publikun shqiptarë se çfarë bën Shqipëria në një ministerial të tillë. Cili është...

» faqe 4-5



ANALIZË

Kosova e lirë dhe pavarur drejt integritetit Euro-Atlantik

» faqe 8

SPECIALE

Teoritë e Mahan dhe Corbett parë në këndvështrimin strategjik

faqe 10-11

NATO

Më shumë mbrojtje dhe më shumë dialog

faqe 13



**KONFERENCËN
E SIGURISË
NË MYNIH**
Lufta në Siri,
katastrofa me emi-
grantët dhe kriza e
sigurisë evropiane
ishin çështjet krye-
sore në axhendën e
kësaj konference.
Konferenca e 52-të
e Sigurisë në Mynih
u zhvillua nën
udhëheqjen e am-
basadorit Eöffgang
Ischinger.

Ministria Kodheli mori pjesë në Konferencën e Sigurisë në Mynih

Ministria e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, mori pjesë në Konferencën e Sigurisë, e cila u zhvillua nga data 13-14 shkurt 2016 në Mynih të Gjermanisë. Në këtë konferencë morën pjesë disa kryetarë shtetesh, shumë ministra të Jashtëm e të Mbrojtjes, si dhe personalitete të njohur të diplomacisë botërore. Kështu ishte i parnjohur sekretari amerikan i Shtetit, John Kerry, homologu i tij rus, Sergey Lavrov, ministri i Mbrojtjes i Britanisë, Michael Fallon, ai i Francës Jean-Yves Le Drian, përfaqësues të qeverisë gjermane, si dhe mjaft personalitete të tjerë. Lufta në Siri, katastrofa me emigrantët dhe kriza e sigurisë evropiane ishin çështjet kryesore në axhendën e kësaj konference. Konferenca e 52-të e Sigurisë në Mynih u zhvillua nën udhëheqjen e ambasadorit Eöffgang Ischinger.

Ministria e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, gjatë punimeve të Konferencës së Sigurisë në Mynih të Gjerman-



isë zhvilloi edhe disa takime dypalëshe me homologë dhe personalitete të njohur. Kështu, ajo zhvilloi një takim me sekretarin britanik të Mbrojtjes, Michael Fallon. Gjatë këtij takimi dy homologët diskutuan për marrëdhëniet dypalëshe dhe projektet e përbashkëta në fushën e mbrojtjes.

Ministria Kodheli vlerësoi maksimalisht mbështetjen që Britania e Madhe jep në edukimin dhe trajnimin e ushtarakëve shqiptarë. Ndërsa, nga ana e tij, sekretari britanik i Mbrojtjes Fallon i konfirmoi ministres Kodheli që Forcat e Armatosura Britanike do të vijojnë me stërvitje të përbashkëta në territorin shqiptar. Stërvitja "Albanian Lion" do të zhvillohet në vjeshtë të këtij viti dhe do të shërbejë rritjes së ndërveprueshmërisë mes dy forcave tona të armatosura.

Ministria Kodheli gjithashtu zhvil-

loi një takim me asistentsekretaren e Mbrojtjes të SHBA-ve për Çështjet e Sigurisë Ndërkombëtare, Elissa Slotkin. Ministria Kodheli e falënderoi zyrtaren e lartë të diplomacisë amerikane për mbështetjen e vazhdueshme që Shtetet e Bashkuara i kanë dhënë Forcave të Armatosura Shqiptare.

Asistentsekretarja e Mbrojtjes amerikane, znj. Elissa Slotkin, ritheksoi rëndësinë që qeveria amerikane i ka dhënë dhurimit të pajisjeve ushtarake që Shqipëria ka bërë për peshmergat në luftën kundër të ashtuquajturit shtet islamik.

Gjatë punimeve të Konferencës së 52-të të Sigurisë në Mynih, znj. Kodheli zhvilloi një takim të veçantë pune dhe me ministren e Mbrojtjes të Italisë, znj. Roberta Pinotti. Të dy autoritetet theksuan rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit mes forcave të armatosura.

Prezantohet komandanti i Qendrës së Vëzhgimit Detar

Në Qendrën e Vëzhgimit Detar (QVD) në Durrës u zhvillua ceremonia e emërimit të komandantit të ri të kësaj qendre, nënkolonel Ulsi Rexhaj. Në ceremoni morën pjesë komandanti i Forcës Detare gjeneral brigade Ylber Dogjani dhe personeli i QVD. Me këtë rast, komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Ylber Dogjani, vlerësoi karrierën dhe aftësitë profesionale të nënkolonel Rexhaj dhe i uroi suksese në detyrën e re si drejtuesi i QVD, si një nga repartet me të rëndësishëm të Forcës Detare.

Nënkolonel Rexhaj është diplomuar në Akademinë Ushtarake në specialitetin ndërlidhje, në vitin 1990. Gjatë karrierës së tij

ka kryer kualifikime të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, si në Turqi, Gjermani etj. Gjithashtu, ka shërbyer në detyra të ndryshme nga komandant toge, instruktor, shef ndërlidhjeje, komandant i ASNI dhe aktualisht komandant i QVD.

Në fund të ceremonies, nënkolonel Ulsi Rexhaj u shpreh: "Emërimin në këtë detyrë e quaj nder dhe përgjegjësi, ndaj së bashku me efektivin e QVD do punojmë për të mbajtur në gatishmëri optimale këtë sistem të rëndësishëm jo vetëm për Forcën Detare, por për gjithë institucionet e tjera detare, pjesë e Qendrës sonë Ndërinstitucionale Operacionale Detare".



Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes

Në AFA certifikohen 29 kursantë që përfunduan Kursin Themelor të Oficerit të Shtabit

Më datën 17.02.2016, në ambientet e Komandës së Doktrinës dhe të Stërvitjes, u zhvillua ceremonia e certifikimit të 29 kursantëve të Kursit Themelor të Oficerit të Shtabit (KTHOSH). Në ceremoni morën pjesë: shefi i Shtabit të KDS, kolonel Selim Troci, komandanti i AFA, kolonel Ruzhdi Kuçi, zv.komandanti i AFA, kolonel Beqir Tafili, përfaqësuesi i CUBIC-t pranë Qendrës së Simulimit, z. Dee Esplin, shefat e departamenteve të FSM, si dhe pedagogët e Akademisë Forcave të Armatosura.

Në fjalën e hapjes komandanti i AFA, kolonel Ruzhdi Kuçi vuri në dukje se programi i kursit u zhvillua me kurrikula të përmirësuara me qëllim realizimin e arsimimit dhe formimit të përgjithshëm të oficerit dhe pajisjen e tij me njohuritë, aftësitë dhe shprehjet më të domosdoshme për punën në grup dhe në shtab në nivel batalioni. "Objektivi ynë ka qënë që ju të kuptoni dhe të aftësoheni si oficer shtabi për të kryer detyra të ndryshme në shtab, të aftësoheni për të punuar në grup ku shtabi të funksionoi si një organizëm i vetëm. Gjatë këtij kursi ju realizuat 4 detyra planëzimi në bashkëpunim me Qendrën e Simulimit, përfaqësuesin e CUBIC-ut pranë QS, z. Dee Esplin, shefat e departamenteve të pedagogë, si dhe personel drejtues të AFA. Në këtë Kurs, moduli i departamentit të operacioneve zinte 80% të programit. Komanda e AFA ka zhvilluar disa takime mbi mbarëvajtjen e kursit me kursantët. Shumica e vërejtjeve dhe sugjerimeve tuaj do të meren parasysh në programin e kursit në vijim", - tha kolonel Kuçi. Më pas, komandanti i AFA falënderoi pedagogët përgjegjës të Kursit, major Genti Bardhi dhe major Gjuran Burnazi, pedagogët e Departamentit të Operacioneve, Qendrën e Simulimit, përfaqësuesin e CUBIC-ut pranë Qendrës së Simulimit z. Dee Esplin, pedagogët që dhanë mësim me kursantët. Gjithashtu ai falënderoi për ndihmesën e dhënë për mbarëvajtjen e Kursit Shtabit të Përgjithshëm të FA, Komandën e Doktrinës dhe të Stërvitjes, si dhe iu uroi suksese kursantëve që sapo përfunduan Kursin.

Në përshëndetjen e tij, shefi i Shtabit të KDS, kolonel Selim Troci, ndër të tjera, vuri në dukje se: "Kursi përbën një eveniment mjaft të rëndësishëm në karrierën tuaj për të kaluar nga baza tek puna në shtab, për t'u përgatitur nga oficer trupe në oficer shtabi. Ju erdhët në këtë Kurs pas një eksperience të përfutur me parë, si dhe pas një përzgjedhje mes shumë kandidatëve. Ju ishit brezi i parë që u ballafaqt me këtë kurrikul dhe keni punuar më së miri. Keni qënë nga kurset më të mira që ka pasur Akademia. Njohuritë që morët do t'ju shërbejnë si busull orientimi gjatë ecurisë së punës tuaj...", - theksoi kolonel Troci. Më



pas, në emër edhe të komandantit të KDS, ai i uroi suksese në karrierën ushtarake dhe shëndet e lumturi në familjet e tyre të gjithë kursantëve që përfunduan me sukses këtë kurs.

Në emër të kursantëve të KTHOSH përshëndeti kapiten Fisnik Shtini, i cili pasi vlerësoi programin e përzgjedhur u shpreh: "Ne si kursantë morën njohuri të thella në fushën operacionale, mësuam procedurën e punës në shtab, procesin e vendimarrjes etj. Me këtë rast, falënderojmë koman-

dantin e AFA, stafin pedagogjik, pedagogët përgjegjës, si dhe familjet për mbështetjen e dhënë gjatë gjithë kursit".

Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit (KTHOSH) ka filluar më datën 20 tetor 2015 dhe u ndoq nga 29 oficerë me gradën kapiten të FA. Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit zë një vend të rëndësishëm në hierarkinë e arsimimit ushtarak që zhvillon Akademia e Forcave të Armatosura. Kursi përbën një hap

cilësor në karrierën e oficerëve të rinj dhe ka për qëllim kryesor të përgatisë oficerë në pozicionet e ndryshme të shtabeve të reparteve, si dhe në shtabe të reparteve e nënreparteve shumëkombëshe në përbërje të strukturave të NATO-s dhe ato ndërkombëtare. Kursi u zhvillua në 15 javë dhe pjesëmarrësit ishin nga Forca Tokësore, Forca Ajrore, Forca Detare, Komanda Mbështetëse, Agjensia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes etj.

Major Elvis Spahi i jepet certifikata "Për shërbime të merituar në FA Amerikane"

Para disa ditësh (12.02.2016), në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes u zhvillua ceremonia e dhënies së certifikatës "Për shërbime të merituar në Forcat e Armatosura Amerikane" studentit të Kursit të Komandës dhe Shtabit (KKSH), major Elvis Spahi. Të pranishëm në ceremoni ishin: komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Dedë Prenga, atasheu ushtarak i SHBA-së në vendin tonë, Kapiten i Rangut II Samuel G. Eartel, komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, kolonel Ruzhdi Kuçi, shefi i ODC, nënkolonel Robert R. Johnston, shefat e departamenteve të Fakultetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, pedagogët të AFA, studentët e KKSH, si dhe të ftuar të tjerë. Atasheu ushtarak amerikan, Kapiten i Rangut II Samuel G. Eartel i dorëzoi major Elvis Spahi certifikatën "Për shërbime të merituar në Forcat e Armatosura Amerikane" akorduar nga Sekretari i Mbrojtjes i Amerikës më 30 janar 2015. Atasheu ushtarak amerikan vlerësoi punën dhe kontributin e major Elvis Spahi në misionin e kryer në periudhën janar-korrik 2014 në Afganistan, si dhe punën e gjithë ushtarakëve shqiptar që kryejnë detyra në misione të ndryshme në kuadër të Aleancës. Komandanti i KDS, gjeneral brigade Dedë Prenga vlerësoi major Spahin për punën e përgjegjshme,

si dhe për përkushtimin dhe arritjet e tij në mision. Ai theksoi se kjo duhet të vlejë si një shëmbull dhe një motivim për të gjithë ushtarakët e tjerë shqiptarë, të cilët gjithashtu kanë shërbyer e do të shërbejnë edhe në të ardhmen në misione dhe do të kryejnë detyra në kuadër të NATO-s. Major Elvis Spahi falenderoi të gjithë institucionet që kishin kontribuar në trajnimin dhe edukimin e tij, duke e bërë atë të aftë të përgjegjshëm për të kryer detyrat edhe në kuadër të Aleancës.

Major Spahi, aktualisht student i Kursit të Komandës dhe Shtabit (KKSH), vjen nga një familje ushtaraku, i edukuar me vlera të larta vetmohimi dhe zbatimi me korrektesë të detyrës. Ai u titullua oficer në vitin 1999 dhe ka punuar në detyra të ndryshme, kryesisht në Batalionin Special. Ai ka qënë gjithashtu pjesë e katër misionëve, dy në Irak dhe dy në Afganistan, në vitet 2006, 2008, 2010 dhe i fundit në periudhën janar-korrik 2014 në Afganistan. Certifikata "Për shërbime të merituar në Forcat e Armatosura Amerikane" ju jepet anëtarëve të koalicionit për kontributin dhe ndihmën që ushtaraket e huaj japin ndaj ushtrisë amerikane.

**Përgatiti: Major Merita Alimuçaj
Specialiste e BCU**





MINISTRJA KODHELI:

Shqipëria bën ekzak-
tësisht atë ç'ka bëjnë
27 vendet e tjera, duke
qenë pjesë e kësaj tryeze
dhe kësaj sipërmarrje të
madhe politio-ushtarake,
sigurisht në përmasat e
Shqipërisë, por unë ju
siguroj se serioziteti me
të cilin diskutohet në
ministerial nga Shqipëria
është i njëjtë me serioz-
itetin që diskutohet edhe
nga vendet e mëdha,
anëtare të NATO-s.

Intervista e ministres Kodheli

Shqipëria është në top listën e kontributeve të mëdha, në rolin e saj të paqes, të sigurisë dhe të rregullit botëror

*Pjesë nga intervista e ministres së Mbrojtjes Kodheli
dhënë gazetarit Roland Qafoku në "Channel One"*

Sa herë zhvillohet ndonjë takim i nivelit të lartë apo një ministerial, si në këtë rast në Mynih, ne gazetarët pyesim: cili është roli i Shqipërisë? A ka ndonjë specifikë këtë herë që ne të themi për publikun shqiptar se çfarë bën Shqipëria në një ministerial të tillë. Cili është roli i shtetit tonë?

Ministrja Kodheli: Shqipëria bën ekzakhtësisht atë ç'ka bëjnë 27 vendet e tjera, duke qenë pjesë e kësaj tryeze dhe kësaj sipërmarrje të madhe politiko-ushtarake, sigurisht në përmasat e Shqipërisë, por unë ju siguroj se serioziteti me të cilin diskutohet në ministerial nga Shqipëria është i njëjtë me seriozitetin që diskutohet edhe nga vendet e mëdha, anëtare të NATO-s. E them këtë sepse shikoj shpesh herë opinione të nxjerra, ndoshta jo dashakeqe, por të dala për shkak të mos njohjes së procesit, mosnjohjes së asaj që Shqipëria dhe FA bëjnë. Ne, krahasuar me numrin e popullsisë dhe numrin e FA-ve që kemi, ju siguroj që jemi në top listën e kontributeve të mëdha, krahasuar me vendet, që realisht vënë rregullin botërorë. Këtë e bëjmë me bindjen se jemi duke bërë më të mirën, e bëjmë me shpresën që t'i tregojmë vetes në radhë të parë dhe të tjerëve që ne dimë t'i bëjmë gjërat mirë dhe se Shqipëria është këtu në rolin e saj të paqes, të sigurisë dhe të rregullit botëror, sepse besojmë tek vlerat mbi të cilat kjo organizatë është ngritur dhe kjo organizatë mbron, pra NATO.

Isha i bindur që ju me këtë entuziazëm do t'i përgjigjeni kësaj pyetje, sepse kështu keni qenë gjithmonë, pozitive në atë që jeni shprehur... Por zonjë nuk janë kaq entuziaste shifrat. As 1 % e GDP-së nuk ka sot buxheti i shtetit shqiptarë për ushtrinë, gjë që nuk është një shifër e kënaqshme?

Ju bëni shumë mirë që pyesni për shifra. Unë tek shifrat ndihem më komode se në çdo gjë tjetër, ndaj po ju përgjigjem me shifra dhe shkurt. Në



Samitin e Uellsit kryetarët e qeverive apo të shteteve morën angazhimin që buxhetet e të gjitha vendeve të NATO-s nuk duhet të zvogëloheshin, përkundrazi duhet të rriteshin dhe të mbërrinin

në nivelin 2 % për të gjithë ata vende që nuk e kanë. Janë pak vende ata që e kanë 2 % apo pak më shumë se 2 % deri në vitin 2020. Shqipëria nga buxheti i vitit 2015 në atë të vitit 2016 është rritur

me 12 % që do të thotë që nga 0.82 % e GDP-së që kemi qenë në vitin 2015 kemi shkuar në 0.94 % të GDP-së.

Domethënë, asgjë?

Domethënë shumë, 12 % është

shumë. Kjo tregon që ne jemi duke e vënë në zbatim këtë gjë.

Kjo llogaritet në buxhetin e Shqipërisë?

Sigurisht që po, nuk llogaritet me buxhetin e Amerikës. Edhe një vend si Italia nuk e llogarit me buxhetin e Amerikës, por e llogarit me buxhetin e vet. Unë ju siguroj që me buxhetin që ne kemi, jo vetëm plotësojmë të gjitha detyrimet tona kushtetuese, por kemi plotësuar një për një edhe të gjitha angazhimet tona në NATO. Madje, unë ju siguroj që megjithë që ne nuk na është kërkuar të rrisim prezencën tonë në Afganistan, ne jemi duke e vlerësuar këtë gjë dhe besoj që do ta dyfishojmë këtë presencë. Kjo është shumë domethënëse për një vend të vogël si Shqipëria.

Unë jo më kot e përmënda pjesën e përqindjes nga Buxheti i Shtetit për MM. Shpesh herë jo vetëm ju, por dhe ushtarakë të lartë të MM kanë përmendur atë që quhet ndryshim ose reformim në pjesën e armatimit dhe teknologjisë në ushtri. Ku jemi realisht me ndërrimin e teknologjisë, armatimit dhe paisjeve ushtarake që ka ushtria shqiptare?

Me krenari mund të them që viti 2015 ishte viti kur u fillua blerja e armatimit të ri të standardeve të NATO-s, pas gjashtë vitesh që Shqipëria ishte bërë anëtare e saj. Deri në atë moment Shqipëria vazhdonte të mbante si armatim bazë të FA armën e vjetër, kallashnikovin.

S'ka më kallashnikov?

Patjetër që ka, sepse është duke u zëvendësuar me etapa.

Kur mbaron kjo?

Ne kemi një plan. Besoj do ta realizojmë përpara kohës, por ajo që dua t'ju them sot është se Batalioni i Dytë i Këmbësisë, i cili është angazhimi ynë në NATO është i kompletuar me armatimin e standardeve NATO me municion e armatim të lehtë dhe të mesëm dhe po shikohet mundësia e kompletimit të tij edhe me mjete të blinduar që konsiderohen lëvizje strategjike dhe jo vetëm kaq. Po kompletohet, sepse nuk është problem vetëm i armatimit, kompleteve të ushtarëve dhe ushtarakëve, i trajnimeve, i mënyrës së përdorimit dhe këmbimit, i kushteve të ruajtjes. Dhe mos harroni një gjë, ne vërtetë po heqim dhe po vëmë një armë të re, por arma e re është shumë më delikate se arma e vjetër, që edhe kur bëhej me baltë prap funksiononte. Duke qenë delikate kërkon disa kushte të caktuar ruajtje, të cilat ishin shumë të këqija. Tunele të pa sistemuara, depot të rrënuara. Ndërkohë që ti blen armatim të ri duhet të bësh edhe këtë lloj investimi. Dhe ne këtë po bëjmë. Do ta vazhdojmë këtë proces. Jemi absolutisht në rrugë të mbarë.

Sa zgjat?

Kompletimi i të gjithë FA nuk do të zgjasë shumë. Problemi është blerja e municionit që zgjat dhe kushton, sepse në këtë proces më shumë kushton municioni sesa arma vetë. Ka një rezervë shtetërore sekrete që mbahet në depot tona, kështu që ngadalë do të zëvendësohet në vite deri sa të mbërrijmë atje ku ne fakt kemi synuar, bazuar në të gjitha dokumentat strategjikë që kemi miratuar në qeveri ose në Parlament.

Ju përmendët një batalion që po e quani si elitën e FA, të cilin ju po e pajisni me armë të reja. Në kuadër të pjesës së ushtrisë shqiptare të NATO-s sa reparte kompani apo batalione kemi ne, që i kemi të gatshme, që në një rast eventual është pjesë e FA të NATO-s për një rrezik të mundshëm?

Batalioni i Dytë i Këmbësisë do të jetë me të gjitha kompanitë e tij, i gatshëm me tre kompni.

A është sekret të thuash që kaq është numri i këtij batalioni?

Jo nuk është sekret. Numri i batalioneve është i bazuar në numrin e batalionit që ka ç'ndodh tjetër, nuk është ky sekret, nuk është ky problem. Ne e dimë numrin e FA që kemi, por ndërkohë ne kemi çuar në misionë kompani nga Batalioni i Parë i Këmbësisë i Vaut të Dejës, ashtu siç kemi çuar kompani nga Batalioni i Tretë në Poshnje. Nuk jemi fokusuar vetëm tek Komandot dhe Forcat Speciale, që kanë qenë të vetmet që dikur shkonin nëpër misionë. Tani jemi duke involvuar të gjithë FA për të qenë të gjithë të gatshëm dhe të përgatitur. Për të mos folur për togat e gatshme të Policisë Ushtarake që është një tjetër elitë në FA. Pra, përgjithësisht të gjithë do të jenë të gatshëm të mund të marin pjesë

në misionë dhe operacione të NATO-s, qoftë brenda, qoftë jashtë vendit.

Ju përmendët edhe mjetet e blinduara. Përveç armatimit të lehtë që janë armët automatike dhe të blinduara, por kemi edhe mjete fluturuese. Në çfarë situatë jemi në këto moment dhe çfarë parashikohet në të ardhmen?

Me mjetet fluturuese ne jemi të kompletuar. Ne sapo përfundam një kontratë të firmosur nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2009, kontratë që i kushtoi shqiptarëve relativisht shtrenjtë, sepse ishte rreth 80 milionë euro. Tani jemi të kompletuar me 6 helikopterët e rinj COUGAR dhe kemi një flotë që varion nga 15 deri në 20 helikopterë, të cilët përdoren për qelime të ndryshme. Sigurisht tani kemi marë nën administrim edhe helikopterët e Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Shëndetësisë, sepse në këtë mënyrë besoj se do të mund të menaxhojmë më mirë të gjithë flotën tonë të helikopterëve, duke i sistemuar ato në të njëjtët hangar, duke përdorur të njëjtën teknologji, duke përdorur të njëjtat trajnime pilotësh e kështu me radhë. Besoj që pilotët tanë janë më shumë sesa të përgatitur. Kanë filluar të fluturojnë natën, sepse dy helikopterët e fundit që kemi blerë të kërkim-shpëtimit janë të paisur edhe me paisje vëzhgimi natën. Kjo e avancohet në aftësitë e pilotëve për



KODHELI: Ju siguroj që jemi në top listën e kontributeve të mëdha, krahasuar me vendet, që realisht vënë rregullin botërorë. Këtë e bëjmë me bindjen se jemi duke bërë më të mirën, e bëjmë me shpresën që t'i tregojmë vetes në radhë të parë dhe të tjerëve që ne dimë t'i bëjmë gjërat mirë dhe se Shqipëria është këtu në rolin e saj të paqes, të sigurisë dhe të rregullit botëror, sepse besojmë tek vlerat mbi të cilat kjo organizatë është ngritur dhe kjo organizatë mbron, pra NATO.

të vepruar edhe në kushte pamundësie dhe kushte të këqija. Do të vazhdojmë të stërvisim pilotët për të fluturuar natën mbi ujë, në det. Helikopterët nga ana e tyre kanë nevojë të paise me mjete luftimi. Pra, ky është në fakt një proces, nuk janë të dhëna njëherë e përgjithmonë. Pilotët kanë nevojë jo vetëm për trajnim për mënyrën sesi i jepet helikopterit, sepse në fund të fundit ata janë helikopterë ushtarakë dhe janë të supozuar të transportojnë trupa, por ndërkohë mund edhe të gjuajnë (goditen), pra duhet dhe të gjuajnë (godasin). Varet nga situata dhe misioni ku ato do të mund të

mernin pjesë. Besoj që tashmë e kemi të kompletur Forcën Ajrore.

Kemi mjete të blinduara lëvizëse?

Mjetet e blinduara lëvizëse sot më të reja i kemi tek Policia Ushtarake. Në Policinë Ushtarake kemi katër mjetet të blinduara, kemi katër të reja, por ndërkohë kemi të trashëguara dhe disa të vjetra, të cilat qeveria italiane, Ministria e Mbrojtjes Italiane, na e ka marrë përsipër të na i rregullojë pa pagesë, në mënyrë që dhe ato të kompletohen. Sigurisht që transportimi strategjik i forcave të këmbësisë



kushton shumë, ndaj është shumë i shtrirë në vite, por ndërkohë ne jemi duke parë mundësinë edhe të të blerjes së këtyre mjeteve nëpërmjet granteve apo nëpërmjet ndihmave që aleatët besoj se, duhet dhe mund t'ia japin Shqipërisë. Në këtë mënyrë them që do të kompletojmë disa struktura shumë më shpejt nga ç'i kemi angazhimet tona apo nga ç'kemi premtuar se duhen bërë.

Çfarë bëhet me mjetet dhe armët e vjetra, a e kemi sot më dhe sa kemi?

Ne e kemi përfunduar procesin e demontimit, në fakt ky është një proces i gjatë, po besoj që është procesi më i suksesshëm i Forcave të Armatosura gjatë gjithë këtyre viteve.

Ju njihni dhe e vlerësoni këtë punë të bërë edhe në qeverisjen e Partisë Demokratike?

Po, sigurisht.

S'është folur ndonjëherë në Parlament për këtë?

E kam thënë që ditën që është mbyllur ky process, që ky është një proces që ka vazhduar gjatë dhe i suksesshëm. Kam falenderuar dhe ata që kanë qenë pjesë e këtij procesi edhe më parë. Mjafton ta them një herë dhe jo domosdoshmërisht çdo gjë duhet ta them në Parlament...

Zonja ministre, më keni habitur dy ditë më parë me një fushatë për rekrutimet në ushtri. Kisha 26 vjet që nuk e kemi dëgjuar atë lloj fushate. Ejani të rinj bëhuni ushtarë, oficerë, nënoficerë, sidomos vajzat. Pse duhet një i ri shqiptarë të bëhet oficer? Asnjë nga ju ministrat nuk dëshiron që djalit apo vajzën e saj

ta bëjë oficer? Pse duhet popullit shqiptar t'ia bëni këtë?

Këtë gjë e thoni ju, po ju nuk e dini se çfarë kanë dëshirë ministrat t'i bëjnë fëmijët e tyre...Përgjithësisht kolegët e mi i kanë fëmijët e vegjël dhe nuk besoj që mendojnë se çfarë do t'i bëjnë fëmijët në të ardhmen...

Nuk është e thënë që të gjithë t'i bëjnë fëmijët oficerë...

Po pikërisht pse askush nuk e di se sa mirë është të aderosh në FA, unë dal dhe flas për këtë gjë dhe në fakt ndofta kam qenë më shumë prezent në media këto kohët e fundit, por

qenë për politikën e dyerve të hapura të NATO-s, politikë e cila u hodh si ide dhe u mbështet fort nga Sekretarja Clinton e asaj kohe gjatë Samitit të Çikagos. Struktura NATO nuk është BE-ja. Ka një rrugë tjetër anëtarësimi. Le të themi, është më e guximshme në përzgjedhjet që bën. Është më pak burokratike, është më shumë ndërvepruese. Kjo i ka facilituar edhe anëtarësimet e Kroacisë, Shqipërisë apo pse jo edhe të Malit të Zi më vonë. Jam më shumë sesa e kënaqur që në hartën e Ballkanit Perëndimorë tashmë nuk mungon asnjë shtet. Të paktën në kufirin adriatik. Kjo e bën

më të sigurtë zonën, e bën më të sigurtë dhe ndërveprues rajonin. Serbia mbetet një ishull, për aq sa unë kuptoj, Serbia do të vazhdojë të luajë fort për të marë ftesën dhe për t'u anëtarësuar në BE, por nuk do të kërkojë të bëhet anëtare e NATO-s.

As nga forcat progresive në Serbi nuk ka sinjale?

Sot për sot dominon ideja e fokusimit tek rruga e BE-së.

Rrugës duke ardhur në shtabin e NATO-s, na treguan një godinë gjigande që ishte godina e re e shtabit të NATO-s. Shefi i misionit tonë këtu, Leonard Demi, na tregoi që edhe misioni ynë do të zhvendoset atje, madje është blerë mbi 1 mijë e ca metra katrorë sipërfaqe toke ku do vendoset misioni. A mund të na tregoni disa detaje më shumë për këtë? Si u arrit kjo që dhe Shqipëria të ketë ambjente dinjitoze?

Në fakt Shqipëria ka të njëjtat ambiente dinjitoze edhe këtu për aq kohë sa të tërë kanë të njëjtat ambiente këtu. Spostimi është një projekt i kahershëm, duhet të kishte mbaruar dhe e gjithë struktura dhe administrata e NATO-s duhet të ishte shpërngulur më herët në ndërtesën e re, por edhe këtu, ju e dini që ka tendera, nuk janë mbaruar gjithë punët, ka shtesë kontrate, sepse nuk është se ndodhin vetëm në Shqipëri këto, ndodhin edhe këtu. Kështu që kjo punë është zgjatur. Shqipëria, bazuar në numrin e saj të përfaqësimit, ka një numër të caktuar metrash katrorë ku do të zhvendoset misioni i saj dhe është detyruar të paguajë për sipërfaqen që do të zërë. Është një pagesë që do të bëhet me këste.

Intervistë me komandantin e Qendrës së Bashkuar Operacionale kolonel Ahmet Leka. 14 vjetori i krijimit të Qendrës së Bashkuar Operacionale, si dhe përmbylljen me sukses e projektit për modernizimin e infrastrukturës, krijimin e ambienteve të reja komode dhe ngritjen e sistemeve moderne në QBO.

MIMOZA GOLIKJA

“Ditë e Hapur në QBO”, ishte një aktivitet që Qendra e Bashkuar Operacionale organizoi në kuadër të ditës së krijimit të saj, por edhe të përmbylljes së projektit për modernizimin e infrastrukturës. Gjatë zhvillimit të aktivitetit jo vetëm u promovuan ambientet e reja por edhe u demonstruan para ministres së Mbrojtjes, zonjës Kodheli, shefit të Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor Jeronim Bazo, gjeneralëve të pranishëm dhe të ftuarëve të të tjerë, disa veprimtari të QBO-së, si pjesë e misionit të saj.

Pas përfundimit të aktivitetit i morrëm komandantit të kësaj qendre kolonel Ahmet Leka këtë intervistë për shtypin ushtarak

Zoti komandant, Ju sot zhvilluat aktivitetin “Dita e hapur në QBO”. Cili ishte qëllimi për këtë aktivitet?

Dita e sotme ishte një ditë feste dhe gëzimi për personelin e Qendrës së Bashkuar Operacionale, që tashmë është organizuar e funksionon si simotrat e saj në vendet e NATO-s.

Sot ne festuam 14 vjetorin e krijimit të kësaj qendre, si dhe përmbylljen me sukses të projektit për modernizimin e infrastrukturës, krijimin e ambienteve të reja komode dhe ngritjen e sistemeve moderne në QBO.

Atmosferën e bëri më të gëzueshme edhe pjesëmarrja në aktivitet e ministres së Mbrojtjes, zonjës Mimi Kodheli dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor Jeronim Bazo, të cilët vlerësuan lart punën e QBO-së në përmbushje të misionit të saj.

Ju sot festuat 14 vjetorin e krijimit të QBO-së. Kaq e re është kjo strukturë?

Si strukturë vërtetë është e re, por zanafillat e saj i ka që mbas çlirimit të vendit ku për ndjekjen e pa ndërprerë të situatës tokësore, ajrore dhe detare dhe të gjithë veprimtarisë, së Forcave të Armatosura në Ministrinë e Mbrojtjes tradicionalisht ka funksionuar Shërbimi i Grupit të Drejtimit. Ky shërbim përbëhej nga Përgjegjësi i Grupit të Drejtimit (PGD) dhe ndihmësi i tij. Drejtorët e drejtorive kryenin shërbimin si Përgjegjës të Grupit të Drejtimit (PGD), ndërsa instruktorët si ndihmës përgjegjës të Grupit të Drejtimit. Shërbime të veçanta si ai i zbulimit, ndërlikoheshin për forcat ushtarake detare e ajrore mbuloheshin nga strukturat përkatëse.

Ndryshimet strukturore të Forcave të Armatosura pas viteve 90, por edhe nevoja për përshtatje me strukturat homologe të vendeve partnere, solli domosdoshmërinë e riorganizimit të Shërbimit të Drejtimit në Forcat e Armatosura. Në prill të vitit 1994 Shërbimi i Drejtimit u disiplinua në TOP “Përgjegjës Grupi Drejtimi” dhe “Ndihmës Përgjegjës Grupi Drejtimi”, ndërsa në vitin 2002 me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 75 datë 14.02.2002



Qendra e Bashkuar Operacionale, pika nevralgjike e komandimit të FA

u krijua Qendra e Bashkuar Operacionale e Forcave të Armatosura

A mund të na jepni një panoramë të shkurtër të reformimit të QBO-së në këto 14 vjet ?

Qendra e Bashkuar Operacionale ka pësuar ndryshime të herpashërshme në raport me reformimin e Forcave të Armatosura, në interes të konsolidimit të saj. Nga dita e krijimit deri më sot, Qendra e Bashkuar Operacionale është

riorganizuar disa herë si në vitin 2004, 2006, 2010, 2012 dhe së fundi në vitin 2014.

Akti i parë për krijimin e QBO-së është urdhri Nr.75 datë 14.02.2002 i Ministrit të Mbrojtjes të asaj kohe “Për organizimin e Qendrës së Bashkuar Operacionale të Shtabit të Përgjithshëm të FA”, akt i cili shënon dhe ditën e krijimit të QBO-së. Me krijimin e Qendrës së Bashkuar Operacionale

të Shtabit të Përgjithshëm të FA si strukturë e veçantë, u shkrinë të gjitha strukturat e shërbimit të përmendura më lart dhe në përbërje QBO-së u ngritën katër zyra si Zyra Operacionale, Zyra e Zbulimit, Zyra e Ndërlidhjes dhe Zyra e Kushtrim-Lajmërimit.

Zyra e Kushtrim Lajmërimit në përbërje të Qendrës së Bashkuar Operacionale lindi si domosdoshmëri nga nevoja për bashkëpunimin, komu-

nikimin dhe koordinimin efektiv me Qendrat Operacionale homologe, si dhe komunikimi në vijimësi me trupat tona paqeruajtëse jashtë vendit si, Irak, Afganistan, Boshje-Hercegovinë, etj. Kjo strukturë ka funksionuar deri në Maj të vitit 2005. Organizimi dhe funksionimi i saj pa dyshim ishte një hap shumë i rëndësishëm përpara, pasi u krijua mundësia e veprimit të përbashkët të ish zyrave të ndara dhe në varësi të ndryshme.

Në vitin 2004, lidhur me disa probleme e shqetësime që kishin lindur për mbulimin e koordinimit të operacioneve të kërkim-shpëtimit dhe sigurimin e komandim kontrollit pa ndërmjetësim, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr.448 datë 20.07.2004 “Për krijimin e grupit të punës për riorganizimin e shërbimit të kërkim-shpëtimit (SAR) në Forcat e Armatosura” u ngrit një grup pune për këtë qëllim i cili pasi shqyrtoi dhe analizoi të gjitha të dhënat e veprimtaritë e strukturave të kërkim-shpëtimit, propozoi që në Qendrën e Bashkuar Operacionale, të ngrihet sektori (qendra) i koordinim-shpëtimit (RCC), propozim i cili u miratua. Në këtë kuadër pësoi ndryshime edhe struktura e QBO-së. U krijuan dy sektor sektori operacionale dhe sektori i kërkim-shpëtimit. Në Qershor të vitit 2005 u bë ç’vendosja e RCC nga Rinasi në ambientet e QBO dhe mori drejtimin nga venddislokimi i ri qershor 2005

Në vitin 2006 u krijua Forca e Bashkuar dhe në këtë kuadër riorganizohet edhe QBO-ja. Me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes Nr. 26, datë 17.01.2007 krijohet Qendra Operacionale e Mbrojtjes me Sektorin e Forcës së Bashkuar, Sektorin i Strukturave Mbështetëse, Sektorin e Strukturave Civile dhe Sektorin e Kërkim Shpëtimit. Aktivizimi i kësaj strukture u bë në shtator të vitit 2007.

Në vitin 2010 suprimohet Komanda e Bashkuar. Në këtë kuadër me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr 151/5, datë 24.12.2009 suprimohet dhe Qendra Operacionale e Mbrojtjes dhe organizohet Qendra e Bashkuar Operacionale me sektorë sipas forcave: Sektori i Operacioneve Tokësore, Seksioni i Operacioneve Detare, Seksioni i Operacioneve Ajrore, Seksioni i Strukturave Mbështetëse dhe Automeve të MM dhe SHP. Në këtë strukturë për herë të parë u ngrit Sektori i Emergjencave Civile, dhe Sektori i Vendit Pritës.

Reforma e thellë në NATO në vitin 2012, solli reformim edhe të Forcave tona të Armatosura. Me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr 434, datë 06.06.2012, u bënë përmirësime edhe në strukturën e Qendrës së Bashkuar Operacionale duke kaluar në përbërje të QBO-së Seksionin e Vendit Pritës.

Në vitin 2014, në strukturën e QBO-së për herë të parë u ngrit Sektori i Planëzimit dhe Vlerësimit të Rrezikut, Sektori i Operacioneve të Bashkuara, Sektori i Kontrollit të Lëvizjes dhe Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit.

Megjithëse është folur shpesh për të, çfarë është QBO-ja dhe cili është vendi dhe roli i saj në strukturën e



KOLONEL AHMET LEKA:

Qendra e Bashkuar Operacionale ka pësuar ndryshime të herpashërshme në raport me reformimin e Forcave të Armatosura, në interes të konsolidimit të saj. Nga dita e krijimit deri më sot, Qendra e Bashkuar Operacionale është riorganizuar disa herë si në vitin 2004, 2006, 2010, 2012 dhe së fundi në vitin 2014.

“Ditë e Hapur” në Qendrën e Bashkuar Operacionale

Në kuadër të ditës së krijimit të Qendrës së Bashkuar Operacionale (QBO), si dhe të përmbylljes së projektit për modernizimin e infrastrukturës së saj, u zhvillua aktiviteti “Ditë e Hapur në QBO”. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte promovimi i ambienteve të reja dhe i demonstrimit të disa veprimtarive të QBO-së, si pjesë e misionit të saj.

Në këtë veprimtari morën pjesë: ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, zv.ministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, komandantë forcash, si dhe drejtues të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm.

Fjalën e hapjes e mbajti komandanti i QBO-së, kolonel Ahmet Leka, i cili i njohu pjesëmarrësit me historikun, misionin, organizimin dhe përgjegjësitë kryesore të kësaj Qendre.

Në fjalën e tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Jeronim Bazo, shpjegoi veprimtarinë e QBO-së edhe në rastet e përkeqësimit dhe përshkallëzimit, gjatë së cilave rrjedhimisht rritet edhe niveli i komandimit. “Qendra e Bashkuar Operacionale është syri, veshi ose pika nevralgjike e komandimit të Forcave të Armatosura”, - tha gjeneralmajor Bazo.

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, falënderoi personelin e kësaj qendre për punën dhe ndihmën që ata kanë dhënë gjatë gjithë këtyre viteve të funksionimit, si dhe bashkëpunimin e ngushtë të saj me institucionet e tjera. “Kjo qendër bashkë me të FA,



i janë përgjigjur qytetarëve shqiptarë në gjithë këto vite të emergjencave të natyrave të ndryshme, duke filluar që nga përmbytjet, tek zjarret, tek problemet që kanë pasur në lidhje me detin, te fatkeqësitë e tjera, procesi i

kërkim-shpëtimit e kështu me radhë. Kjo Qendër është sot shumë herë më e strukturuar dhe më e fokusuar tek detyrat e saj primare dhe ajo çka është më e rëndësishme, është që kjo qendër sot është më bashkëpunuese me gjithë

strukturat e tjera institucionale, të cilat shteti ka të ngritura për të gjitha rastet e emergjencave të çfarëdolloj natyre. Është më vendimmarrëse dhe më e pavarur përgjatë zinxhirit të komandimit, nga çka qenë deri dje.” - tha

ministrja Kodheli.

Gjithashtu, ministrja Kodheli foli edhe për ndryshimet dhe investimet që janë bërë me qëllim funksionimin sa më efikas të qendrës. “Vëmendja që i është dhënë kësaj qendre, na ka shtyrë të riformatojmë këtë qendër nëpërmjet edhe një investimi prej 12 milionë lekë të reja, të cilat kanë bërë të mundur përmirësimin e kushteve të punës, kanë bërë të mundur përmirësimin e mjediseve dhe mënyrës se si sot përgjigjemi ndaj emergjencave të çfarëdolloj natyre dhe sigurisht që kjo është pjesë dhe vazhdimësi e të gjithë procesit të modernizimit të FA-ve, në të cilin ne tashmë i jemi futur kësaj rruge të pandalshme dhe pa kthim, çka i bën mirë FA-ve vetë, i bën mirë përgjigjes që ne japim për detyrimet kushtetuese dhe angazhimit në NATO.” - nënvizoi Kodheli.

Për të pranishmit u bë testimi i komandim - kontrollit (C2) nëpërmjet zhvillimit të një VTC-je (video-telekonferencë) në kohë reale me forcat kryesore. Ndërsa zgjidhja e një detyre (situatë) në rast emergjence civile, ishte programi në vazhdim i “Ditës së Hapur në QBO”.

Në fund, ministrja e mbrojtjes Kodheli dhe të gjithë pjesëmarrësit e tjerë në këtë aktivitet vizituan ambientet e Qendrës së Bashkuar Operacionale dhe panë nga afër punën e personelit të saj.

Forcave të Armatosura

Qendra e Bashkuar Operacionale është strukturë e veçantë, permanente e Shtabit të Përgjithshëm të FA, në vartësi të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm në mbështetje të detyrave të komandim-kontrollit për administrimin e operacioneve në kohë paqe, krize e lufte, me veprimtari të pandërprerë në 24 orë.

Ajo është strukturë operacionale për monitorimin dhe mbajtjen e gjendjes së gatishmërisë dhe në të njëjtën kohë strukturë administrative për ndjekjen e veprimtarive të përditshme gjatë dhe pas orarit të punës.

Pas kompletimit me përfaqësues të drejtorive të SHPFA, QBO koordinon planëzimin, organizimin dhe koordinimin e operacioneve të FA, për rastet e emergjencave e situatave kritike humanitare në të gjitha format që shfaqen dhe fazat e zhvillimit të tyre, si dhe ndjek zbatimin e detyrave të planëzuara dhe të miratuara për njësitë e repartet e FA.

Përsa i përket vendit dhe rolit QBO-ja është qendër e nivelit operativ - strategjik, është pjesë integrale e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm dhe instrumenti kryesor i SHSHP dhe Ministrisë së Mbrojtjes për drejtimin operativ të FA. Ajo ushtron autoritet të deleguar nga Ministri të Mbrojtjes dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Cili është misioni i QBO-së dhe

cilat janë përgjegjësitë kryesore të saj?

QBO mbështet procesin e komandim-kontrollit në nivelin operativ-strategjik për veprimtarinë operacionale të FA, si dhe koordinon kryerjen e operacioneve të kërkim shpëtimit dhe EC në RSH nëpërmjet delegimit të autoritetit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe të Ministrisë së Mbrojtjes

Përgjegjësitë e QBO-së janë të shumta, por më kryesoret janë menaxhimi i informacionit, menaxhimi i situatave gjatë krizave dhe emergjencave civile, kërkim shpëtimit, procedurat e vendit pritës (HNS), kontrolli i lëvizjes dhe detyra të tjera administrative.

Shpesh po flitet për vendimin e fundit të Këshillit të Ministrave për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e EC dhe krizave. Cila është risia e këtij vendimi?

Para se të flas për këtë dua të theksoj se QBO-ja mund të jetë ndër strukturat e vetme në Forcat e Armatosura, që për veprimtarinë e saj ka më shumë akte ligjore e nënligjore si: Ligji nr. 64/2014, datë 26.06.2014 për “Pushetjet dhe Autoritetet e Drejtimit e të Komandimit të FARSH” i ndryshuar, ligji nr. 8756, date 26.03.2001 “Për Emergjencat Civile”, ligji nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e ven-

dosjes dhe kalimit të Forcave Ushtarake të huaja në territorin e RSH, si dhe për dërgimin e Forcave Ushtarake Shqiptare jashtë vendit”, ligji nr. 10435, datë 23.06.2011 “Për shërbimin SAR në RSH”, VKM nr. 742, datë 16.10.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e QKKSH”, VKM nr 965, datë 2.12.2015 “Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e EC dhe krizave”, Urdhri i Ministrisë së Mbrojtjes, nr 12, datë 08.01.2016 “Për delegim të autoritetit të komandimit e kontrollit në rastet e emergjencave civile dhe krizave” etj.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.965, datë 2.12.2015 “Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e EC dhe krizave” është me të vërtetë një vendim mjaft i rëndësishëm. Mbi bazën e këtij vendimi mundësohet një përgjigje më e shpejtë edhe më efikase në rastet e emergjencave civile dhe krizave.

Sipas këtij vendimi ngrihen struktura të drejtimit dhe të menaxhimit të krizave dhe emergjencave civile, si dhe sigurohet bashkëpunimi ndërinstitucional i qendrave operacionale/ zyra e informacionit dhe menaxhimit të emergjencave dhe krizave, nëpërmjet delegimit të kompetencave nga ministrat, si dhe rritet eficaenca e strukturave reaguese për përballimin e krizave dhe emergjencave civile.

Ky vendim reduktoi burokracinë për përdorimin e strukturave operacionale në përgjigje të situatës nëpërmjet delegimit të kompetencave QBO-së për përdorimin e aseteve të caktuara të Forcave të Armatosura me kërkesë të Drejtorisë së përgjithëshme të Emergjencave Civile.

Dalja e këtij vendimi plotësoi boshllëkun ligjor për përdorimin e kapaciteteve ushtarake për periudhën deri në shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Po me procedurat Standarde të Veprimit si punohet në QBO?

Të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura duhet të punojnë me Procedura Standarde Veprimi, por për QBO-në, kjo është domosdoshmëri në kuptimin e vërtetë të fjalës. Situatat që përpunohen e vlerësohen në QBO nuk pranojnë hutim e paqartësi në reagim. Për të kërkohej shpejtësi, saktësi, radhë punë standarde. Për këtë qëllim në QBO janë përgatitur e miratuar rreth 12 Procedura Standarde Veprimi (PSV) ku më kryesoret mund të përmendim: PSV për “Emergjencat Civile” të kodifikuar EC-328/10, PSV për nivelet e angazhimit të QBO-së dhe FA në Emergjencat Civile e kodifikuar EC-328/11; PSV “Për shërbimin e Kërkim -Shpëtimit” e kodifikuar PSV-332/10; PSV “Mbështetja e Vendit Pritës” e kodifikuar PSV-480/10; PSV “Procedura standarde për kontroll-lëvizjen

e mjeteve të transportit” e kodifikuar KL-490/20; PSV “Për ngjarjet e jashtëzakonshme” e kodifikuar NJ-322/10 etj

Ju sot promovuat dhe përmbylljen me sukses të projektit për modernizimin e infrastrukturës, krijimin e ambienteve të reja komode dhe ngritjen e sistemeve moderne në QBO. Diçka në lidhje me këtë.

Vitin e kaluar QBO-ja u vendos në ambientet ku jemi sot, por jo në këto kushte. Falë investimit për këtë qëllim, sot, QBO ka ambiente mjaft komode për punë, ka një sallë operacionale bashkëkohore për shërbimin në detyrë (24/7/365), sallën VIP, një sallë të vlerësimit të rrezikut, një sallë të planëzimit operativ dhe ambiente pune komode për të gjithë personelin me sistem ajrimi e kondicionimi.

Në QBO janë ngritur e funksionojnë sisteme moderne bashkëkohore si ai i pasqyrimin dhe vëzhgimit të situatës ajrore dhe detare, sigurisë dhe vëzhgimit me kamera, komunikimit dhe internetit etj

Duke përfunduar, cilat janë projektet tuaja për të ardhmen?

Ne shikojmë vetëm përpara duke përmirësuar aktet ligjore e nënligjore, procedurat standarde të veprimit, infrastrukturën dhe trajnuar me tej personelin për të qenë gjithmonë në gadishmëri të plotë.

Më 17 shkurt 2008 lindi shteti më i ri në botë

KOSOVA

e lirë dhe pavarur drejt integritetit Euro-Atlantik

PËRGATITI: ALBERT Z ZHOLI

Rruga drejt pavarësisë

Vala e fundit e lindjes së disa shteteve në Evropë u bë në dekadën e fundit të shekullit që kaloi nga shkatërimi i federatave. Kështu ndodhi ndarja e republikave të ish-Bashkimit Sovjetik, ndarja e Çekisë nga Sllovakia, ndarja e republikave të ish-Jugosllavisë etj. Lindja e këtyre shteteve u bë duke u bazuar në parimin e të drejtës ndërkombëtare i njohur si “Parimi i së Drejtës për Vetëvendosje”. Por, për fat të keq, kjo mënyrë e ndarjes paqësore nuk ndodhi edhe me Republikën Federative të Jugosllavisë. Pas shpalljeve të pavarësisë së tyre nga Jugosllavia, shtetet e ish-federatës u përballën me agresion nga ana e Serbisë, e cila pretendonte veten si trashëgimtare të Jugosllavisë. Republika e Sllovenisë për arsye të rrethanave specifike, si pozitës gjeostrategjike të saj, kaloi lehtë nga kjo luftë, kurse Kroacia dhe Bosnje-Hercegovina u përballën me një luftë shkatërrimtare.

Të njëjtën gjë përjetoi më pas edhe Kosova. Kosova është vendi i fundit që e fitoi mëvetësinë si rrjedhojë e shpërbërjes së përgjakshme të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Në fakt, lëvizjet për liri e pavarësi në Kosovë kishin filluar më herët, nën drejtimin Ibrahim Rugovës. Në vitin 1990, Kosova u shpall republikë dhe në vitin 1991 shtet i pavarur, mirëpo nuk arriti ta jetësonte pavarësinë e vet në rrethanat e pushtimit ushtarak serb që zgjati plot një dekadë (1989-1999). Qëndresa paqësore mbarëpopullore, Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) me në krye komandantin legjendar Adem Jashari, 1997-1999 dhe ndërhyrja ajrore e NATO-s në pranverë të 1999 i dhanë fund genocidit të Serbisë mbi popullatën shqiptare të Kosovës. Trupat e NATO-s hynë në Kosovë në qershor 1999, ndërsa po largohej ushtria serbe dhe Kosova u administrua nga një mision i Kombeve të Bashkuara deri në 2008. Më 17 shkurt 2008, Kosova u shpall shtet i pavarur dhe sovran



Lufta e Ushtrisë Çlirimtare (1997-1999) dhe ndërhyrja ajrore e NATO-s në pranverë të 1999 i dhanë fund genocidit të Serbisë dhe triumfit të pavarësisë së Kosovës



dhe deri më tani është njohur nga 110 vende në mbarë botën.

Lindja e shtetit të Kosovës si rast i veçantë

Nga kundërshtarët e pavarësisë së Kosovës është përfolur shumë se Kosova e pavarur do të krijonte precedent edhe për rastet e tjera në botë. Por, me të drejtë, shumë përkrahës të pavarësisë së Kosovës janë shprehur se, pavarësia e saj është rast i veçantë (sui generis), i cili nuk mund të krahasohet nga rastet tjera “të ngjira”, të cilat presin zgjidhje. Kosova është rast unik, i cili nuk mund të krahasohet me asnjë rast tjetër në botë për faktin se:

- Kosova ka një histori të veçantë;
- Kosova ishte pjesë përbërëse e një federate që tani më është shuar, kurse Kosova ishte element konstituiv i kësaj federate;
- Në Kosovë ka ndodhur pastrimi etnik, gjenocid me përmasa tronditëse për bashkësinë ndërkombëtare;
- Në Kosovë një ndërhyrje ndërkombëtare, në parandalimin e një tragjedie, konflikti me përmasa që do t'i kalonin kufijtë rajonal;
- Kosova gjendet nën administrimin ndërkombëtar;
- Përbërja e popullsisë mbi 90%

etnike shqiptar;

- Kosova ka kufijtë e saj të definuar e të njohur nga shtetet e rajonit etj.

Pas gjithë asaj çfarë ka ndodhur në Kosovë?

Interesimi i faktorit ndërkombëtar ka qenë mjaft i madh. Shpeshherë në mediumet e jashtme, Kosova ka qenë ngjarja kryesore. Asnjëherë më parë opinioni publik ndërkombëtar nuk ka qenë aq shumë i informuar, si dhe i interesuar rreth këtij problemi. Tanimë kur Kosova është në fazën përfundimtare të zgjidhjes politike, faktori politik ndërkombëtar ka një përcaktim mjaft të drejtë, përkrahja për një “Pavarësi për Kosovën” sa vjen e bëhet masive në botë, me përjashtim të faktorit rus dhe disa vendeve të tjera më pak të rëndësishme. Kohëve të fundit, Rusia edhe pse anëtare e Grupit të Kontaktit, si dhe e pajtuar me parimet e 31 janarit 2006 të këtij grupi rreth zgjidhjes së statusit final të Kosovës, ka dalë fuqishëm kundër pavarësisë së Kosovës, duke u ndalur në qëndrimin se “marrëveshja duhet të jetë e pranuar për të dyja palët”.

Shteteve e Bashkuara të Amerikës dhe Britanisë së Madhe, dështuan në përpjekjen për të fituar përkrahjen



e Rusisë dhe Kinës, si anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për të sjellë në Rezolutë, ku do të aprovohehin rekomandimet e Presidentit Ahtisari, që Kosova të jetë shtet i pavarur dhe sovran. Propozimi i Presidentit Ahtisari ishte rezultat i bisedimeve e zhvilluara në mes të Kosovës dhe të Serbisë të zhvilluara në Vjenë të Austrisë. Sipas kësaj rezolute, Kosova pranohet si shtet i pavarur me një mbikëqyrje të përkohshme ndërkombëtare. Iniciativa e këtyre shteteve ishte rruga me e mirë e përfundimit të statusit të Kosovës, pasi që në këtë mënyrë Kosova menjëherë do të ishte anëtare e Kombeve të Bashkuara. Dështim i këtij projekti politik, detyroi Kuvendin e Kosovës në një mbledhje të jashtëzakonshme, me 17 shkurt 2008 të shpalli Kosovën shtet i pavarur dhe sovran.

Njohjet ndërkombëtare

Pas shpalljes së Pavarësisë, njohje të menjëhershme erdhën nga shtetet më të fuqishme të botës, si SHBA, Britania e Madhe, Franca, Italia, Turqia etj. Vala e njohjeve ka vazhduar me intensitete të ndryshme dhe deri më sot numri i shteteve që kanë njohur Kosovën është mbi 110. Rëndësia e numrit të njohjeve është mjaft e madh në aspektin politik, pasi që në këtë mënyrë paraqesin presion serioz kundër argumentit për mosnjohjen e Kosovës. Bazuar në të drejtën ndërkombëtare dhe në kriteret nga konventa e Monte Videos, Kosova me shpalljen de facto dhe de jure është shtet me subjektivitet ndërkombëtar. Është e rëndësishme së veçantë politike se njohjen e Republikës së Kosovës e kanë bërë në mënyrë masive shtetet e Bashkimit Evropian. Shtete që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, si Spanja, Greqi, Qipro, Sllovakia apo Rumunia janë shtete të cilat kanë probleme të brendshme dhe i frikohen

lëvizjeve politike të brendshme. Edhe sot e kësaj dite disa shtete që hezitojnë të njohin shtetin e Kosovës janë grupi i shteteve të cilat në konceptet e tyre politike janë kryesisht shtete me sisteme jo-demokratike me probleme të brendshme dhe përket nuk paraqesin arsyetim real të mosnjohjes.

Mendimi në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë

Ofensiva e Serbisë për të penguar njohjen e pavarësisë së Kosovës ishte menjëherëshe, por pa ndonjë rezultat. Njëra nder format e kundërshtimit dhe ndaljes se njohjeve të pavarësisë së Kosovës ishte kërkesa e Serbisë për interpretim të legjitimitetit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Në pyetjen drejtuar gjykatës nëse pavarësia e Kosovës ishte shpallur në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, gjykata u përgjigje qartë: Shpallja e Pavarësisë së Kosovës nga Kuvendi i Kosovës nuk ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Mendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ishte grushti i fundit më i rëndë për Serbin. Pas këtij mendimi të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë vazhduan njohjet ndërkombëtare, duke shterur kështu shpresat e Serbisë për të siguruar përkrahje ndërkombëtare për të penguar njohjet e Kosovës. Vendimi i Gjykatës ndikoi edhe në qëndrimin e opinionit. Disa nga partitë politike, si dhe personalitete të njohur serb në vazhdimësi bëjnë thirrje për njohjen e pavarësisë së Kosovës nga Serbia.

Sot Kosova është një vend i pavarur që punon me përkushtim maksimal në rrugën e demokracisë, me synimin dhe objektivin e madh për t'u bërë pjesë e integritetit euro-atlantik, në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Kjo është një rrugë e pandalshme dhe e pakthyeshme.

SHEFAQET KËRCELLI

Specialisti i mjeteve të rënda të ushtrisë Alfred Tarja dhe “TAKRAFI” i tij i pavdekshëm...

Ja kushtoj gjithë specialistëve e punonjësve civilë të FA, të cilët çdo ditë me mund, thonj e djersë përdorin, mirëmbajnë dhe i shërbejnë sektorit mekanik që ushtria shqiptare ka sot në përdorim



Gjatë këtyre ditëve të ngrohta të shkurtit midis punëve të shumta që po kryhen në Forcën Detare, bie në sy dhe pastrimi i kurorës së palmave të vjetra që qarkojnë ambientin përreth Komandës dhe Shtëpisë së Pushimit të Ushtrisë Durrës. Janë mbi 100 e ca palma të cilat nga koha, moskujdesi dhe faktorët e motit thahen, zenë krimba dhe bëhen kështu bartës të baktereve e sëmundjeve të ndryshme, pse jo dhe shpërndarës të sëmundjeve të rrezikshme që po përhapen sot në planetin tonë. (Mendoj se personeli ynë shëndetësor në FD duhet të bëjë dhe studime të mirëfillta analitiko-shkencore, për këto palma, jo vetëm mbasi të ngacmuar sadopak nga puna e këtyre njerzve të thjeshtë, por dhe nga fakti se pasi poshtë këtyre palmave lëvizin me dhjetra ushtarakë të gradave të ndryshme)...Gjithsesi kjo situatë nuk ka qenë jashtë vëmendjes së Komandës së FD dhe Kompanisë Mbështetëse të saj. Kështu bazuar në një Urdhër të komandantit të FD, gjeneralbrigade Ylber Dogjani për pastrimin e palmave dhe mjedisit përreth, manovratori i mjeteve të rënda të Batalionit të Transportit, Alfred Tarja dhe specialisti të Kompanisë Logjistike të Shtabit pastruan palmat e shumta nga degët e infektuara që bartnin rrezik sëmundjesh. E shihja çdo mëngjes një mjet të rëndë 12.5 tonësh, tip ADK, “TAKRAF”, i cili më kujtonte kohët e vjetra, kur këto mjete monotoni bunkerë dhe sisteme fortifikimesh, një moment meditimi për mua. Vërtet sot destinacioni i tyre ka ndrruar plotësisht... pasi ato përdoren gjësisht në punimet e shumta ndërtuese dhe mjedisore të FA, ose për komunitetin civil. Gjithsesi i mora pak kohë protagonistit të këtyre punëve, specialistit të këtij mjeti të rëndë, për të më shpjeguar diçka më tepër për median. Është e vështirë që këta njerëz me kominoshe plot njolla vaji e hidrokarburesh dhe me duart plot kallo të flasin për veten. Ata janë fjalëpakë e punë shumë, sic thotë populli, paguhen pak, ndërkohë që në FA, japin kontribut të pazvëndësueshëm. Këto “specie të rralla” në FA, i gjen kudo, në gjithë teatrin e operacioneve që kryen FA në vendin tonë; sa në ngarkim-shkarkimin e lëvizjen e municioneve, në emergjencat tokësore, përmbytje, mjedis, ngritjen e kampingjeve të FA dhe aletëve të NATO-s, larg zhurmës e fjalëve boshe. Ata gjatë gjithë kohës kanë dëshirë të dëgjojnë vetëm zhurmën e motorëve dhe agregatëve të tyre, për të kapur para kohe difektin e mundshëm, bashkë me peripecitë dhe burokracitë shkresore që shoqëron mirmbajtja dhe riparimi i cdo difekti. Një nga këta është dhe personazhi i këtij përshkrimi, specialisti manovrator Alfred Tarja. Në fakt fillësë e këtij shkrimi ishte pamja që më afrooi para disa ditëve, “bordimi” i një “TAKRAFI” para Komandës së FD, i cili për dhjetë ditë qëndronte hijerëndë në sheshin para kësaj Komande. E di mirë historinë e futjes së tyre në Ushtrinë e dikurshme, kur drejtor Logjistike në FA ishte zoti Arqile Veshi, por nuk ma merte mendja që këta ekzemplarë do ishin gjallë?! Pasi me sa di të gjithë institucionet tona shtetërore, madje dhe private, të cilat morën në pronësi nga ishbatalionet e fortifikimeve një sasi të këtyre mjeteve nga inventari i FA, i kanë hequr nga përdorimi dhe i kanë zvëndësuar me tipa moderne me fuqi e kapacitete më të madhe ngritëse e shkarkuese. Ndaj kërshëria ime shkoi më tej, për të takuar të zotin e kësaj specie mekanike, pa të cilën nuk do ishin ndërtuar ata mijëra bunkerë të famshëm të diktaturës. Kush fshihej vallë mbas kabinës me xhama të lëpyrur nga mjedisi?! Me këtë ndjesi dhe mori mendimesh që më përshkuan në çast si ish ushtarak e takova të zotin e këtij mjeti, zotin Alfred Tarja. Me ndihmuan disa kolegë të tij në FD, që ja dinin tipin, se vështirë ti nxirrje nonjë fjalë EDI-t, (siç i flasin shkurt) për veten. Një mesoburrë, rreth të dyzetave, qytetar tipik i Shqipërisë së Mesme, mbasi i afrova një cigare, se rakinë as që e fuste në gojë, më foli

diçka. Që kur isha i vogël, nga dritarja e shtëpisë sime afër një milje tokësore nga reparti i Oficinës Lëvizëse të FA, pranë Institutit Bujqësor Kamzë, shihja me kërshëri disa Vinca, Zisa, Motogjen-eratorë të prodhimeve të ndryshme Lindore (me motorë perëndimorë) dhe njerëz me kominoshe që mbushnin hapësirën e këtij reparti të vogël ushtarak, tregon Alfredi. Kështu një ditë të bukur, në vitin 2004, mbas përfundimit të shkollës së mesme dhe shërbimit ushtarak mu plotësua dëshira për të shërbyer në ushtri si manovrator.

Fati dhe vështirësia qëlluan bashkë për mua. E quaj veten me fat, pasi “TAKRAFI-n” tim e kishte drejtuar një specialist me emër në ushtrinë shqiptare, i ndjeri Lavdërim Babaliu, i cili e mbylli karrierën e tij me këtë “TAKRAF”, duke kryer një punë të lavdërueshme e fisnike, për kombin. E pra, ky ishte mjeti që ngarkoi bustin e Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti, Skënderbeut në “Skanien” që e transportoi atë në Prishtinë. Pjesa e fatit tim ishte dhe njohja me specialistët me emër të kësaj fushe në ushtrinë shqiptare,

profesionistë të shkëlqyer dhe njerëz me zemër të madhe. Midis tyre Fadromistin Hatem Muçollari, 30 vjet punë e sakrificë në ushtri me mjete të rënda, ditë dhe natë, në kohë të mirë e të keqe, i cili u bë mjeshtri dhe mësuesi im më i mirë në këtë profesion. Por zanati kishte dhe anën tjetër të medaljes, vështirësinë e mjeteti dhe zanatit. E mora “TAKRAFI”-in të plakur, pa rininë e dikurshme kur cdo pjesë e tij shkëlqente dhe kishte parametrat e duhur. Difekte pa fund, punë hekurash. Ka 12 vjet që punoj, i shërbej dhe e mirëmbaj këtë mjet. Më është bërë shok, mik e kushëri, pjesë e dashurisë e jetës së përditëshme. Nuk numurohen punët që ka kryer. Me të kam ngarkuar e shkarkuar mijëra tonë municione, mjete e pajisje ushtarake, kontainierë për fushimet e aleatëve të NATO-s në Bizë, Feken, Martanesh, Karaburun, Pashaliman, e kudo që kërkohej. Sigurisht që më vështirë e kam pasur në situatat e krijuara gjatë emergjencave natyrore, përmbytjeve në Shkodër e Vjosë, kur përdorimi i këtij mjeti në terren të rënduar ishte thuajse i pamundur, më thotë Edi. Jam ndjerë mirë kur kam përcjellë ngarkesa kryesisht kontainierë bashkë me kolegët amerikanë, se ata dinë të vlerësojnë njeriun e mirë dhe specialistin. Manovratorët e gjejnë gjuhën shpejt, teknika futet tek shkencat ekzakte dhe nuk pranon fjalë të tepërta e rrenat. Por puna e personazhit tonë nuk mbaron këtu. Ai ka tre vjet që me kujdesin e një manovratori dhe specialisti mjedisi, bashkë me personelin e Kompanisë logjistike dhe Shtëpisë së Pushimit të Ushtrisë Durrës, pastron palmat dhe pemët e tjera nga degradimi. Në dukje një punë e lehtë, por që bart plot vështirësi teknike gjatë prerjes, pasi punohet në lartësi dhe ndotje mjedisore. Gjithsesi Edi me shokët e tij ja kanë marrë dorën, ata i gëzohen punës së tyre dhe produktit që japin për pastrimin e mjedisit. Gjeografisë dhe shumëllojshmërisë së zbatimit të detyrave në FA nga këta specialistë të padukshëm i bashkohet dhe puna për lëvizjen e mjeteve të ndryshme ajro-tokësore-detare, avionë, helikopterë, tanke, topa, Katera Silurues, të trashëguara me shumicë para viteve '90, për tu bërë pjesë e Muzeumit të FA. Në këtë mënyrë “TAKRAFI” 30-vjeçar dhe i zoti i tij Alfred Tarja, si vëllezër siamezë janë pjesë e historisë së sotme të ushtrisë shqiptare. Ëh, Po! Ka ngelur vetëm diçka, që ky mjet gjermano-japonez i viteve '80, “TAKRAF”-i, ta zerë vendin e tij, në pavionin ose eksponatin e fundit të Muzeut të Ushtrisë, pasi ai gjatë këtyre viteve i ka përcjellë të gjitha speciet teknike bashkëkohore në këtë muze. Pra, kjo specie mbyll historinë e ushtrisë shqiptare deri në vitin '90. Që mos më keqkuptojnë lexuesit, “TAKRAFI” është pjesë e produktit moshor, jo e misionit. Ndërsa i zoti dhe përdoruesi i tij për një duzinë vitesh, specialisti i aftë dhe i ndershëm, personazhi i këtij shkrimi, zoti Alfred Tarja, të vazhdojë punën atje, në repartin e vet në Pezë, duke u kujdesur për mjetet e reja me të cilat Forcat tona të Armatosura janë pajisur gjatë këtyre viteve. Natyrisht që këta njerëz që rrezatojnë punë e mirësi janë pjesë e krenarisë së FA shqiptare bashkë me pagëruajtësit, dhe për këtë vlerësimi ndaj tyre i kalon caqet e këtij shkrimi.

Teoritë e MAHAN dhe CORBETT parë në këndvështrimin strategjik



Nënkolonel ARIJAN SHKURTA
Kursant në KLO

Fuqia detare sipas Mahan

Si një oficer marine, profesioni i Mahanit, i dha punës së tij në një farë mënyre vlerësim, kur vepra e tij u publikua për herë të parë. Në shkrimet e tij Mahani ishte një mbrojtës i fuqishëm i flotës britanike dhe betejat e marinës që ai përshkruante u bënë shumë popullore në fillim të shekullit 20, ishte koha kur fuqi të mëdha po përfshihen në luftëra detare. Këto gjëra do të shikohen më me shumë detaje, duke bërë një krahasim të Japonisë që në shumë mënyra ishte e njëjta me flotën e Britanisë së Madhe, ajo do të dilte si një flotë e integruar në fillim të shek. XX dhe në një farë mënyre do të përligjte teorinë e Mahanit.

Gjithsesi mësimet e nxjerra nga luftimet e flotës Japoneze në vitet 1904-1905 dhe flotës Amerikane në Luftën e Dytë Botërore, duhet të ketë shfaqur indikacionet në teorinë e Korbetit mbi përparësinë e komandës së detit mbi luftën detare që ishte më e aplikueshme se sa teoria e Mahanit. Për këtë qëllim diskutimet se lufta detare nuk është një luftë që përcakton luftën në tërësinë e saja. Në të vërtetë lufta detare do të jetë në nivelin taktik një shënjes domethënëse të një krahu kundërshtar mbi tjetrin. Por për këtë nuk mund të themi plotësisht që kërkimet e Mahanit ishin tërësisht të pavlera. Duke e parë në këndvështrimin e vlerësimit taktiko-operacional, tregojnë se zotërimi detar për planëzuesit ushtarak mund të jetë një refleksim për luftën në tërësi kur faktori kryesor mund të jetë ai detar. Edhe pse konkluzionet e Mahanit janë disi pak më të kufizuara në krahasim me ato që Korbeti paraqiti.

Mahan, nëpërmjet shkrimeve të veta donte të influenconte vendin e tij, këtu del edhe mendimi ideologjik që ai kishte. Mahan pranon vetë që librat i ka shkruar vetëm për zhvillimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Veprat e Mahan-it janë një filozofi e tipit pozitiviste, filozofi e cila bie dakord me



mentalitetin amerikan të asaj kohe.

Dy objektivat kryesore mbi fuqinë detare sipas Mahan janë: përcaktimi i ndikimit të fuqisë detare për fatet e kombit; nëpërmjet studimit të luftës detare të formulonte disa parime themelore dhe të qëndrueshme të strategjisë detare, të krahasueshme me parimet e luftës tokësore të formuluar nga Jomini. Pikëpamjet Mahan u formuan nga konfliktet në shekullin e shtatëmbëdhjetë ndërmjet Republikës së Holandës, Anglisë, Francës, Spanjës dhe nga luftërat detare të shekullit të nëntëmbëdhjetë në mes Francës dhe Britanisë, ku superioriteti i marinës britanike përfundimisht mundi Francën, vazhdimisht duke parandaluar pushtim dhe bllokadën detare.

Theksi mbi kontrollin e tregtisë të përdorur në det është i zakonshëm, por në shekullin e nëntëmbëdhjetë, nocioni ishte radikal, veçanërisht në një komb krejtësisht të fiksuar me zgjerimin

në tokën perëndimore të kontinentit. Teoria Mahan nuk mund të shpjegojë suksesin e perandorive tokësore, të tilla si Gjermania Bismarkiane. Megjithatë, bllokada e marinës mbretërore që i bëri Perandorisë Gjermane ka qenë një faktor kritik direkt dhe indirekt në kolapsin eventual gjerman.

Në studimet e bëra nga Mahan arrihet në përfundimin se “kontrolli i detit është një faktor historik, i cili asnjëherë nuk ishte vlerësuar dhe shpjeguar në mënyrë sistematike”. Konfiguracioni fizik i një vendi përcakton në një shkallë të lartë edhe synimet e një populli për të siguruar Fuqinë Detare. Përbërja e bregdetit përcakton shkallën e kalueshmërisë për në det; portet e mira rrisin mundësitë për fuqinë detare; përbërja e tokës mund t'i largojë njerëzit nga deti ose t'i afrojnë me të për të siguruar jetesë më të mirë. Madhësia dhe karakteri i popullsisë, duhet të merren



Mahan, nëpërmjet shkrimeve të veta donte të influenconte vendin e tij, këtu del edhe mendimi ideologjik që ai kishte. Mahan pranon vetë që librat i ka shkruar vetëm për zhvillimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Veprat e Mahan-it janë një filozofi e tipit pozitiviste, filozofi e cila bie dakord me mentalitetin amerikan të asaj kohe.

në konsideratë në llogaritjen e fuqisë detare.

Karakteri dhe qëndrimet kombëtare janë faktorë thelbësorë të suksesit të një populli që ushtron veprimtari detare. Karakteri i shtetit ka rëndësi jetike për arritjen e Fuqisë Detare. Sukseset më të larta janë arritur nga ato shtete që kanë përcaktuar dhe ndjekur me këmbëngulje dhe zgjuarsis interesat kombëtare në lidhje me detin.

Zotërimi i një pozicioni qendror, sipas Mahanit, ofronte të njëjtat përparësi mbrojtëse dhe mësymëse si në det, ashtu edhe në tokë. Një pozicion i tillë do të siguronte “linja të brendshme, linja më të shkurtra, të cilat do të përdorëshin për të sulmuar”. Faktikisht, një linjë e brendshme do të ishte “një zgjerim i pozicionit qendror”, ose “një sërë pozicioneve qendrore të lidhura me njëri-tjetrin”. Zotëruesi i linjave të tilla do të kishte mundësi të bënte përqëndrimin e forcave në secilin nga frontet e ndryshme më shpejt se armiku dhe rrjedhimisht do t'i përdorte forcat më me efektivitet.

Në sistemin e Mahanit termi “komunikim” nënkupton “linjat e lëvizjes midis forcave dhe burimeve të furnizimit të tyre”. Komunikimi, është elementi më i rëndësishëm në strategji, qoftë politik ose ushtarak; epërsia e fuqisë detare qëndron në kontrollin e linjave të komunikimit. Një pozicion qendror që siguron mbrojtjen e linjave të komunikimit ofron përparësi të mëdha.



Përqëndrimi i forcave, është një parim themelor si në luftën detare, ashtu edhe në atë tokësore. Vlera e pozicionit qendror qëndron pikërisht në faktin se ai lehtëson, në të vërtetë, nxit përqëndrimin e forcave. Po kështu Mahani konstaton se në qoftë se “qëllimi i vërtetë” i Forcave Detare “është arritja e epërsisë mbi flotën e armikut dhe kontrolli i detit, atëherë anijet dhe flota e armikut duhet të jetë objekt i sulmit në të gjitha rastet.

Thelbi i doktrinës strategjike të Mahanit ishte domosdoshmëria e kontrollit të detit, gjë që, sipas tij, mund të bëhej vetëm me përqëndrimin e forcave të afta për të larguar anijet luftarake dhe tregtare nga deti.

Në qoftë se qëllimi kryesor i flotës luftarake nuk është ndjekja e flotës kundërshtare, por kontrolli i detit, atëherë karakteristika themelore e një flote të tillë nuk duhet të jetë shpejtësia, por fuqia e veprimit mësymës. Për një shtet që ka një flotë të vogël, sugjeron Mahani, veprimi më i dobishëm do të ishte ta mbyllte atë në një port të pathyeshëm dhe ta detyronte në këtë mënyrë armikun të angazhonte forca për një roje të përhershme për të mos lejuar flotën të dalë nga porti.

Teoritë e Sir Julian Corbett

Revolucioni Amerikan shfaq një inters të veçantë mbi teorinë e fuqisë detare. U studiuan të dyja teoritë duke i krahasuar për disa kontraste që paraqesin. Në fillim të luftës Amerikane nuk kishin aspak ndonjë fuqi sinjifikative detare. Në këtë kohë flota Britanike kishte një strategji për të patur një superioritet në det duke arritur një bllokadë për vendet kundërshtare ajo kishte mundësi për të krjuar një liri



veprimi për kolonitë e saj dhe për ti krijuar mundësinë komponentit tokësor mundësi për një manovër të trupave nëpërmjet detit për ti çuar ato kudo ku e kërkonte situata. Deri në këtë kohë Britanikët ishin të suksesshëm. Ekonomia e Britanisë ishte shumë e përhapur, ushtria kontinentale ishte e vogël për ti patur forcat e saj kudo megjithëse kishte mundësi për të manovruar, në sajë të kapaciteteve detare që kishte. Ajo mund të ishte shkatërruar e tëra ndërkohë që një pjesë e trupave të saj ishte e zënë me mbrojtjen e New Yorkut. Kur kjo balancë forcash ndryshoi në vitin 1778, Britania e gjen veten e saj në marrjen fund si një fuqi e madhe dhe e padiskutueshme detare deri në atë kohë. Në këto kushte kursi më i mirë i veprimit për Britanikët do të ishte bashkimi i flotës luftarake detare me qëllim që të shmangte disi goditjen përfundimtare që mund ti jepej nga kundërshtarët. Ishte e qartë që flota Britanike nuk ishte më e sigurtë siç kishte qënë kohë më parë, asaj i duhej një strategji e re. Britanikët e gjetën veten në numër shumë të pakët duke luftuar në teatro të ndryshëm dhe të shpërndarë në detra lokalë. Këtë e provon, beteja në Kepin e Virginias ku ushtria franceze korr fitore mbi atë britanike.

Forcat franceze fituan në det dhe në tokë forcat e Kornwallit u izoluan dhe duke sjellë edhe disfatën e tyre njëkohësisht. Ky shembull mund të jetë shumë i saktë po të merret parasysh teoria e Korbetit i cili shprehet që operacionet tokësore me ato detare duhen koordinuar kjo bëhet për të arritur një rezultat vendimtar në tokë. Ndoshta shembulli më i spikatur që mbështet

teorinë e Korbetit është beteja e Atlantikut në Luftën e Dytë Botërore. Në këtë rast termi betejë mbase keqpërdoret sepse në këtë rast u implikuan ngjarje të cilat patën lidhje me njëra tjetrën. Gjatë betejës së Atlantikut shumë anije u mbytën në mënyrë të shpejtë nga të dyja palët kundërshtare por gjithsesi

anijet luftarake ishin një mbështetje e veprimeve tokësore dhe ajo u shpërngul në shumë raste edhe në det.

Kur SHBA u fut në luftë në fund të vitit 1941, e gjeti veten e saj në përgjithësi jo të përgatitur kur u gjetën përballë anijeve “U” të gjermanëve. Në këtë kohë admiral Donitz hodhi



Rubrika: Flasin studentët e Kursit të Lartë të Oficerit në AFA

Studentët pjesëmarrës në KLO kanë nisur realizimin e detyrave individuale, sipas temave të lëndës “Teori të luftës dhe strategjisë”, nën drejtimin e petagogut Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj. Me këtë rast, gazeta “Ushtria” çel rubrikën “Flasin studentët e Kursit të Lartë të Oficerit në AFA” nëpërmjet së cilës do të pasqyrojë herë pas here esse, recensa dhe opinione të përzgjedhura nga studentët pjesëmarrës në këtë Kurs, të cilat gjykojmë se vlejné të njihen dhe studiohen edhe nga ushtarakë të tjerë të niveleve të ndryshme të Forcave tona të Armatosura.

një numër anijesh sulmuese në lindje të bregut lindor të SHBA, të cilat arritën rezultate të mira dhe i gjetën të papërgatitur nëndetëset gjermane që ishin të dislokuara në vijat lëvizëse të Atlantikut dhe për të bërë veprime subversive në këto linja. Në këtë kohë amerikanët kishin mësuar nga mësimet britanike mbi përdorimin e flotës dhe ato për herë të parë bënë një shoqërim të flotës mbiujëse edhe me një shoqërim nënujor pra duke futur edhe shoqërimin me nëndetëse me qëllim për të bërë sa më të sigurt kalimin e tyre.

Edhe pse flota e SHBA në fillim i injoroi këto mësimet të Mahnit, për të bërë përqendrimin e flotës dhe për ta bërë grupimin e gjuajtësve kundër nëndetësve Gjermane, më vonë ajo filloi ti krijonte ato dhe munda të kishte sukses përcaktues në det. Prova e drejtuesve dhe dështimet e tyre në të kuptuarit e objektivit Kurbetian solli në fillimet e luftës detare, në fillim disa beteja u humbën. Kjo gjë solli për flotën amerikane në gjashtë muajt e parë të luftës detare një humbje serioze. Fatmirësisht flota e SHBA adoptoi dhe ndërtoi një rendim luftues, por edhe më të mirë se sa flota britanike.

Mësimet

Dikush mund ta përmbledhë teorinë e Mahanit si përqendrim të flotës së vendit, që ka qëllim të shkatërronë flotën armike në një betejë detare përcaktuese. Ndërsa teoria e Corbettit, nga ana tjetër, përshkruhet si një teori që përfshin “sigurinë e komandimit të detit dhe të parandalonë armikun të sigurojë të tijin”. Corbett vazhdon duke thënë që, “komanda e detit ka për qëllim, kontrollin e vijave detare dhe atyre të komunikimit, duke përfshirë ato tregtare dhe ushtarake”. Edhe pse teoria e Mahan dhe Corbett nuk janë opozitare dhe kanë një kohë të gjatë që janë shkruar, vazhdojnë të jenë edhe sot e kësaj dite aktuale për hegjemoninë e detrave. Duke parë nën këndvështrimin e teorisë së Mahan dhe Corbett, revolucionin Amerikan, luftën Ruso-Japoneze, në Luftërat Botërore, dikush do të shpallë dhe të tregojë se më kryesore për detin është siguri i

linjave të komunikimit dhe jo fitimi i betejave detare.

Testi final është më tepër teorik sesa logjik bazuar në historinë detare. Duke e parë nga perspektiva e planëzimit ushtarak, është e vështirë që të planëzosh një betejë vendimtare detare si objektiv. Njëri nga palët mund të identifikojë pikat, nëse ai kërcënohet, ai mund të provokojë flotën armike të mësyje. Ndërkohë forcat tokësore mund të zhvillojnë një rrethim të gjatë dhe mund të shkatërronë forcat kundërshtare, vetëm një bllokadë e ngushtë mund të arrijë një objektiv të qartë detar. Ndërkohë, bllokimi i forcave ka të ngjarë të jetë subjekt i forcave mbrojtëse, si tek zbulimi Japonez tek Port Arthur. Në kundërshtim me fokusimin mbi kontrollin e vijave detare që çojnë në logjikën e thjeshtë për sigurimin e rrugëve duhet shikuar gjithashtu edhe avantazhi që mund të krijohet duke kërkuar ndeshjen me betejë detare me kundërshtarin. Edhe pse plani famoz, që japonezët kishin hamendësuar, për të mësyre dhe dhënë betejë në kohë dhe vend flotës amerikane, këta të fundit zgjodhën, që është një hamendësim domethënës për një ngjarje të tillë kritike.

Kontrolli i vijave të komunikimit ose siguri i tyre lejon ata të kenë një rol kryesor në luftë dhe në një farë mënyrë të jesh predominant në komponentin luftarak detar. Beteja vendimtare detare, gjithsesi, është relativisht e largët. Por edhe ky përfundim nuk mund të jetë si një provë finale, thjesht për faktin sepse për njërin palë kërkimi i betejës detare është e rëndësishme ndërsa për palën tjetër ka rëndësi kontrolli i vijave detare. Ky mësim është i vështirë për të mos u mësuar sidomos për oficerët e marinës që trajnohen dhe përgatiten për betejat detare. Vetëm një superfuqi siç janë tani SHBA mund të vazhdojnë dhe të fokusohen në qëllimet e tyre për të adaptuar shpejt dhe të godasin rrezikun tjetër që mund të shfaqet në vijat e komunikimit detar, i cili mund të jetë një rrezik tjetër i “anijeve-U Gjermane” të rrezikut asimetrik, dhe të vazhdojnë të mbajnë statusin e superfuqisë.

Aleatët e NATO-s qëndrojnë krah për krah në luftën kundër terrorizmit

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, dënon fuqishëm sulmin në Ankara

Deklaratë, pas sulmit terrorist në Ankara më 17 shkurt 2016

Unë dënoj fuqimisht sulmin terrorist i cili goditi në zemër të Ankarasë sonte, duke synuar autobusë që mbanin personelin ushtarak.

Shpreh ngushëllimet më të thella për familjet e të vrarëve

dhe të popullit turk. Mendimet e mia janë edhe me ata që janë plagosur. Nuk mund të ketë justifikim për akte të tilla të tmerrshme. Aleatët e NATO-s qëndrojnë krah për krah në luftën kundër terrorizmit.



Këshilli NATO -Rusi, në kërkim të dialogut politik

MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg morri pjesë në Konferencën e Sigurisë në Mynih, më 12-13 shkurt 2016, në sfondin e një mjedisi të ndryshuar të sigurisë. Ai gjithashtu zhvilloi takime të tjera të rëndësishme, ku temat kryesore të bisedimeve ishin mbi sfidat e sigurisë dhe situatën e krijuar. Sfidat nga lindja dhe jugu, duke përfshirë rolin e NATO-s në trajtimin e krizës së refugjatëve dhe emigrantëve, ishin në agjendën e takimit të Stoltenberg edhe me Sekretarin e Jashtëm britanik Philip Hammond. Stoltenberg u takua dhe me Përfaqësuesin e Lartë të BE, nënkryetarin e Komisionit Evropian Federica Mogherini për të diskutuar nevojën për një bashkëpunim edhe më të ngushtë mes NATO-s dhe BE-së pas vendimit të Aleancës për të vendosur në Egje Grupin e Dytë të Qendrueshëm Detar. Gjithashtu më parë, Stoltenberg foli për bashkëpunimin BE-NATO në trajtimin e krizës së refugjatëve dhe emigrantëve me Presidentin e Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker dhe Presidentin Donald Tusk të Këshillit të Evropës. Stoltenberg u takua edhe me Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Lamberto Zannier, për të diskutuar gjendjen e armëpushimit në Ukrainën Lindore, nevojës për transparencën dhe parashikueshmërinë në aktivitetet ushtarake në Evropë, si dhe forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në mes të NATO-s dhe OSBE-së.

Po ashtu Stoltenberg zhvilloi një takim me ministrin e Jashtëm rus Lavrov. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg dhe ministri i Jashtëm rus Sergei Lavrov shqyrtuan marrëdhëniet NATO-Rusi dhe ranë dakord për të vazhduar mbi eksplorimin e mundësive të një takimi të Këshillit NATO-Rusi. Sekretari i Përgjithshëm bëri të qartë se për NATO-n, agjenda e takimit të mundshëm të NRC-së duhet të përfshijë veprimet e Rusisë në Ukrainë, si dhe nevojën për mekanizma të forta për transparencën dhe parashikueshmërinë e aktiviteteve ushtarake. NATO pezulloi bashkëpunimin praktik për shkak të aneksimit ilegal dhe të paligjshëm të Krimesë nga Rusia, por kanalet e dialogut politik mbahen të hapura.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg foli për mediat pas takimit të tij me ministrin e Jashtëm Lavrov i Rusisë.

Në deklaratën e tij për mediat Stoltenberg, tha se “përfundoova një takim me ministrin Lavrov dhe fokusi ynë ka qenë në marrëdhëniet mes NATO-s dhe Rusisë. Ne gjithashtu adresuam çështjen e thirrjes në një takim të Këshillit të Rusisë në NATO. NRC nuk



